

KALENDARI I TRYEZAVE TË KONSULTIMIT DHE KËSHILLIMIT PPIE 2026

Kapitulli 9 “Shërbimet Financiare”

Qershor 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Qëndrueshmërinë Operacionale Digjitale

Tema 1: Prezantim mbi ecurinë e procesit të integritit në kuadër të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”

Tema 2: Prezantimi i draft-rregullores “Për qëndrueshmërinë operacionale digjitale”.

- i. Objekti, qëllimi dhe kuadri ligjor i draft-rregullores;
- ii. Përputhshmëria me Rregulloren (BE) 2022/2554 (DORA);
- iii. Fusha e zbatimit, subjektet e mbuluara dhe bashkëpunimi institucional.

Tipologjia: Closing Benchmark / Agjenda Evropiane / Informim dhe Ndërgjegjësim

Korrik 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Fondet e Pensionit Privat

Tema 1: Prezantimi i objektivave të procesit të përafrimit të projektligjit “Për fondet e pensionit privat” me Direktivën IORP II.

Tema 2: Prezantimi i ndryshimeve të propozuara në projektligj:

- i. Qeverisja dhe administrimi i rrezikut;
- ii. Skemat e pensionit privat dhe veprimtaria ndërkufitare;
- iii. Mbikëqyrja me bazë rreziku dhe proporcionaliteti.

Tema 3: Roli dhe përgjegjësitë e shoqërive administruese të fondeve të pensionit.

Tipologjia: Closing Benchmark / Informim dhe Ndërgjegjësim

Gusht 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Obligacionet e Mbuluara

Tema 1: Prezantimi i kuadrit ligjor dhe i kriterëve të emetimit të obligacioneve të mbuluara, përfshirë përafrimin me acquis të BE-së, subjektet emetuese dhe kushtet që duhet të përmbushen.

Tema 2: Asetet mbuluese, cilësia e portofolit dhe mekanizmat e mbrojtjes së investitorëve.

Tema 3: Ndikimi i obligacioneve të mbuluara në zhvillimin e tregut të kapitalit, veçanërisht në rritjen e burimeve alternative të financimit dhe thellimin e tregut financiar.

Tipologjia: Closing Benchmark / Agjenda Evropiane

Shtator 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive në Tituj të Transferueshëm

Tema 1: Prezantimi i draftligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm”, përfshirë përafrimin me acquis të BE-së dhe standardet e mbikëqyrjes.

Tema 2: Kriteret për organizimin, administrimin dhe funksionimin e fondeve të investimit, përfshirë rolin e shoqërive administruese, depozitarit dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm.

Tema 3: Mbrojtja e investitorëve, transparenca dhe detyrimet për informim, me fokus në rritjen e besimit të publikut.

Tipologjia: Closing Benchmark / Agjenda Evropiane

Shtator 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Menaxherët e Fondeve të Investimeve Alternative

Tema 1: Prezantimi i draftligjit “Për menaxherët e fondeve të investimeve alternative”, përfshirë përafrimin me acquis të BE-së.

Tema 2: Organizimi, funksionimi dhe detyrimet e menaxherëve të fondeve alternative, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, konfliktet e interesit, vlerësimin e aktiveve dhe rolin e depozitarit.

Tema 3: Mbrojtja e investitorëve, transparenca dhe raportimi periodik, me fokus informimin e investitorëve profesionistë/të kualifikuar dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të fondeve alternative.

Tipologjia: Closing Benchmark / Agjenda Evropiane

Tetor 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit

Tema 1: Prezantimi i draftligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, përfshirë përafrimin me acquis të BE-së dhe forcimin e mbikëqyrjes së tregut.

Tema 2: Kërkesat për licencim, qeverisje dhe administrim të rrezikut nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, duke përfshirë aftësinë paguese, transparencën dhe standardet e raportimit.

Tema 3: Mbrojtja e konsumatorit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tregut të sigurimeve, me fokus në rritjen e besimit, trajtimin e dëmeve dhe përmirësimin e shërbimeve për të siguruarit.

Tipologjia: Closing Benchmark / Informim dhe Ndërgjegjësim

Nëntor 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Tregjet e Instrumenteve Financiare

Tema 1: Prezantimi i draftligjit “Për tregjet e instrumenteve financiare”, përfshirë përafrimin me acquis të BE-së dhe standardet për funksionimin transparent të tregut.

Tema 2: Organizimi, funksionimi dhe mbikëqyrja e tregjeve financiare, duke përfshirë rregullat për pjesëmarrësit e tregut, ndërmjetësit financiarë, platformat e tregtimit dhe raportimin e transaksioneve.

Tema 3: Mbrojtja e investitorëve, transparenca dhe integriteti i tregut, me fokus parandalimin e abuzimit të tregut, rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin e tregut të kapitalit.

Tipologjia: Closing Benchmark / Informim dhe Ndërgjegjësim

Dhjetor 2026 - Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Shoqëritë e Sigurimit dhe Risigurimit

Tema 1: Prezantimi i draftligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, përfshirë përafrimin me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare për menaxhimin e krizave në sektorin e sigurimeve.

Tema 2: Planet e rimëkëmbjes dhe masat ndërhyrëse për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, duke përfshirë rolin e Autoritetit, mekanizmat e parandalimit dhe veprimet në rast të përkeqësimit financiar.

Tema 3: Mbrojtja e të siguarve, stabiliteti financiar dhe vazhdimësia e funksioneve kritike, me fokus në minimizimin e ndikimit në treg dhe ruajtjen e besimit të konsumatorëve.

Tipologjia: Closing Benchmark / Informim dhe Ndërgjegjësim / Agjenda Evropiane

Përmbledhje

- **Numri i takimeve:** 1-2 takime në muaj
- **Periudha:** Qershor – Dhjetor 2026
- **Gjithsej:** 8 tryeza konsultimi dhe këshillimi
- **Fokusi kryesor:** Piketat mbyllëse dhe legjislacioni i Kapitullit 9, progresi i integritimit evropian dhe informimi i komunitetit të biznesit dhe grupeve të tjera, si akademia, shoqëria civile, etj.